

ASISTENCA E RIINTEGRIMIT PËR EMIGRANTËT

në kuadër të Programit të
Riintegrimit të BE-së



VERSIONI SHQIP

Jemi këtu për t'ju mbështetur



Qendra Evropiane
e Teknologjisë dhe
Trajtimeve



FE
Makers
EGYPT

caritas
international,be

WELDO
Rebuilding Lives



IRARA

CILAT JANË AVANTAZHET E KTHIMIT VULLNETAR?

Ne e kuptojmë që kthimi në vendin tuaj të origjinës mund të jetë i vështirë. Ne jemi këtu për t'ju mbështetur. Ne mund t'ju ndihmojmë që të përgatiteni për udhëtimin dhe t'ju informojmë për mundësitë që do të keni sapo të mbërrini.

Nëse keni vendosur të ktheheni vullnetarisht apo nëse jeni objekt i një vendimi kthimi nga autoritetet kombëtare të shtetit anëtar në fjalë, ju mund të kualifikoheni për të marrë asistencë lidhur me riintegrimin në shoqërinë e vendit tuaj të origjinës. Frontex, Agjencia Evropiane e Rojës Kufitare dhe Bregdetare, ka zhvilluar një program të quajtur **Programi i Riintegritimit i BE-së**, që bashkëpunon me organizatat e shoqërisë civile në vendin tuaj të origjinës. Këto organizata kanë përvojë në ofrimin e asistencës për riintegrimin dhe janë të gatshme t'ju mbështesin në lidhje me rikthimin në vendin e origjinës.

KTHIMI MUND TË DUKET I KOMPLIKUAR. AI MUND T'JU NGREJË SHUMË PIKËPYETJE DHE T'JU SHKAKTOJË GJENDJE ANKTHI. STAFI I SPECIALIZUAR, SI P.SH. KËSHILLTARËT PËR KTHIMIN DHE RIINTEGRIMIN DO TË JENË NË DISPOZICIONIN TUAJ PËR T'JU MBËSHTETUR ME OFRIMIN E PËRGJIGJEVE. ATA DO T'JU NDIHMOJNË MBI ASPEKTET LIGJORE, ADMINISTRATIVE DHE PSIKOSOCIALE TË LIDHURA ME KTHIMIN DHE RIINTEGRIMIN, DUKE JU UDHËZUAR DREJT ZGJEDHJEVE TË DUHURA PËR TË ARDHMEN TUAJ.

Njoftoni Këshilltarin tuaj për Kthimin dhe Riintegrimin nëse keni nevojë për kujdes të veçantë, për shembull, nëse jeni një person i mitur i pashoqëruar ose një grua shtatzënë, nëse keni qenë viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore apo nëse keni probleme shëndetësore ose aftësi të kufizuara, ose nëse po ktheheni bashkë me fëmijët. Këshilltari do të sigurohet që çdo problem apo rrethanë personale përkatëse të merret parasysh në mënyrë që të përshtatet më së miri me llojin specifik të mbështetjes për riintegrimin.

A KUALIFIKOHEN PËR ASISTENCË PËR RIINTEGRIMIN?

Ju mund të merrni asistencë për riintegrimin nëse:

- a. **Nuk keni marrë ende një vendim negativ përfundimtar** lidhur me kërkesën tuaj për vendqëndrim, vendbanim të ligjshëm dhe/ose mbrojtje ndërkombëtare (azil) dhe vendosni që të ktheheni. Në këtë rast, ky konsiderohet **kthim vullnetar**.
- b. **Keni marrë një vendim negativ përfundimtar** dhe/ose një “vendim kthimi”, ku përcaktohet afati brenda të cilit ju duhet të largoheni nga territori i shtetit anëtar. Ju keni marrë vendimin për t'u kthyer në vendin tuaj të origjinës. Në këtë rast, ky konsiderohet largim vullnetar. Autoritetet kombëtare të shtetit evropian ku po qëndroni do t'ju informojnë rreth mundësisë për marrjen e asistencës së riintegritit dhe afatit brenda të cilit duhet të largoheni nga vendi.

NËSE GËZONI TË DREJTËN E VENDQËNDRIMIT, VENDBANIMIT TË LIGJSHËM DHE/OSE MBROJTJE NDËRKOMBËTARE NË TERRITORIN E NJË SHTETI ANËTAR TË BE-SË, JU NUK KUALIFIKOHENI PËR ASISTENCË RIINTEGRIMI.

- c. **Keni marrë një vendim kthimi**, siç shpjegohet në pikën b, dhe keni zgjedhur të mos largoheni brenda afatit të përcaktuar (largimi vullnetar). Në këtë rast, vendimi i kthimit bëhet i detyrueshëm dhe ju pranoni pasojat e kthimit të detyruar.

Vini re se shtetet anëtare të BE-së janë përgjegjëse për të vendosur nëse mund të kualifikoheni ose jo për asistencë riintegrimi, sipas legjislacionit të tyre të brendshëm, kur dorëzoni aplikime për Programin e Riintegritit të BE-së.

CILAT JANË LLOJET E DISPONUESHME TË ASISTENCËS PËR RIINTEGRIM?

Programi i Riintegritit i BE-së përfshin dy lloje asistencash:

Asistencë afatshkurtër: Pas mbërritjes, juve mund t'ju ofrohet mbështetje e menjëhershme gjatë ditëve të para, si p.sh. transport nga aeroporti, akomodim afatshkurtër, asistencë mjekësore, transport vijues deri në destinacionin e synuar, bashkim familjar dhe mbështetje financiare të kufizuar.

Asistencë afatgjatë: Plani i riintegritit mund të zhvillohet për një periudhë deri në 12 muaj. Këshilltari juaj për Rikthimin dhe Riintegrimin në vendin pritës dhe organizata jonë në vendin e origjinës do të diskutojë me ju opsionet më të mira dhe do të dakordësohet mbi zbatimin e tyre sapo të ktheheni. Disa shembuj të asistencës afatgjatë për riintegrimin përfshijnë:

STREHIM AFATGJATË DHE MBULIM TË KOSTOVE PËRKATËSE

ASISTENCË MJEKËSORE E RREGULLT

ARSIMIM (SHKOLLIM DHE FORMIM PROFESIONAL)

KËSHILLIM PËR PUNËSIM DHE ASISTENCË PËR PËRFSHIRJE NË TREGUN E PUNËS

ASISTENCË PËR HAPJEN E NJË BIZNESI TË VOGËL

BASHKIM FAMILJAR

KONSULENCË LIGJORE DHE MBËSHTETJE ADMINISTRATIVE

MBËSHTETJE PSIKOSOCIALE

Në të dyja rastet, ju do të merrni mbështetje të specializuar nga Organizata Partnere për Riintegrimin, e cila do të monitorojë planin tuaj të riintegritit dhe mund t'ju ndihmojë duke ju referuar pranë organizatave të tjera.

ÇFARË MUND TË PRES NGA KËSHILLTARI PËR KTHIMIN DHE RIINTEGRIMIN?

Gjatë seancave këshilluese personale me një këshilltar për kthimin, ju do të merrni informacione të dobishme mbi mundësitë tuaja të kthimit dhe mbi alternativat për mbështetje dhe asistencë për riintegrim. Këshilltari juaj është i trajnuar për t’ju mbështetur dhe mund t’i përgjigjet të gjitha pyetjeve që mund të keni. Ju mund të pyesni Këshilltarin për Kthimin dhe Riintegrimin në çdo kohë për të drejtat që gëzoni lidhur me aplikimin tuaj. Gjatë një seance këshilluese, ju mund të kërkonti një interpretues nëse nuk ndiheni komodë që të flisni në të njëjtën gjuhë si këshilltari.

Nëse shprehni interes për marrjen e asistencës për riintegrim, Këshilltari juaj duhet të mbledhë disa informacione të rëndësishme për të përpunuar aplikimin tuaj. Do t’ju kërkohet të jepni informacione lidhur me dokumentet tuaja të identifikimit, anëtarët e familjes dhe mundësisht edhe për të dhënat e tyre të kontaktit dhe vendndodhjen e tyre. Informacioni i vënë në dispozicion do të mblidhet në përputhje me kërkesat ligjore për mbrojtjen e të dhënave. Mos ngurroni të informoni Këshilltarin tuaj për çdo nevojë të veçantë që mund të keni.

Gjatë aplikimit do t’ju kërkohet të plotësoni një formular dhe t’i jepni Frontex autorizimin për të përdorur të dhënat tuaja personale. Ky informacion është i nevojshëm për Organizatën Partnere për Riintegrim në mënyrë që të konfirmojë identitetin tuaj dhe do të përdoret vetëm për këtë qëllim, në përputhje me Rregulloren e Përgjithshme Evropiane për Mbrojtjen e të Dhënave.

SHËNIME

ÇFARË MUND TË PRES NGA ORGANIZATA PARTNERE (LOKALE) PËR RIINTEGRIM?

Në vendin tuaj të origjinës, rasti juaj do të trajtohet nga Organizata Partnere për Riintegrim. Nëse keni kërkuar asistencë afatshkurtër, organizata partnere mund t'ju presë në aeroport dhe t'ju mbështesë lidhur me nevojat më urgjente. Nëse keni zgjedhur të merreni asistencë për një periudhë më të gjatë, organizata jonë partnere për riintegrim do të mbetet në kontakt me ju, ndërkohë që ju do të keni mundësi të merrni përgjigje për pyetjet që mund të keni. Jeni gjithmonë të mirëpritur që të kontaktoni me organizatën tonë partnere. Në rast se keni pyetje apo paqartësi mos ngurroni aspak që të kontaktoni Organizatën Partnere për Riintegrim.



ËSHTË E RËNDËSISHME TË THEKSOHET SE:

Organizata Partnere për Riintegrim ose organizatat partnere lokale të saj do t'ju asistojnë gjatë orarit të punës.

Sjellja abuzive dhe/ose agresive ndaj Organizatës Partnere për Riintegrim ose ndaj një organizate partnere lokale është e papranueshme.

Organizata Partnere për Riintegrim nuk mund të zgjidhë të gjitha problemet me të cilat mund të përballeni; ata mund t'ju ofrojnë vetëm asistencën për të cilën keni rënë dakord paraprakisht.

Për të filluar aplikimin, ju nevojitet një dokumentet identifikimi.

Ju duhet të nënshkruani formularin e pëlqimit për të përmbyllur procesin e aplikimit.

KONTAKTONI ME ORGANIZATËN PARTNERE PËR RIINTEGRIMIN NË VENDIN TUAJ.

Të gjitha informacionet mund të gjenden në këtë faqe interneti →

